

VENDIM
Nr. 112, datë 27.3.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 161, DATË 17.6.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘VOKOPOLA ENERGJI’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et ‘VOKOPOLA 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw, ‘VOKOPOLA 2’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw, DHE ‘VOKOPOLA 3’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 143/4 prot., datë 24.3.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instalua 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 161, datë 17.6.2022, ka licencuar shoqërinë “Vokopola Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, bordi i ERE-s me vendimin nr. 311, datë 30.11.2022, ndër të tjera ka vendosur:

- Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e vendimit:

- a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;

- b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;

- c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

- Me dokumentacionin e depozituar në ERE, rezulton se shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. ka plotësuar germën “a” dhe “d”, të pikës 2, të vendimit nr. 161/2022, i ndryshuar, ndaj vlerësohet që të shfuqizohen.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në germën “b” të pikës 2, të vendimit nr. 161/2022, i ndryshuar shoqëria ka depozituar në ERE kontratat e rinovuara, përkatësisht me Bashkinë Skrapar (afati i vlefshmërisë deri më 19.12.2023), Bashkinë Poliçan (afati i vlefshmërisë deri më 30.10.2024) dhe Bashkinë Memaliaj (afati i vlefshmërisë deri më 20.12.2023), ndaj vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të paraqesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë gjerat “a”, “b” dhe “d”, të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 161, data 17.6.2022, i ndryshuar.

2. Pika 2, e vendimit nr. 161, datë 17.6.2022, i ndryshuar, ndryshon si vijon:

Shoqëria “Vokopola Energy” sh.p.k., të paraqesë në ERE kontratat e qirasë me afate të rinovuara, jo më vonë se data 21.12.2023 (me Bashkinë Skrapar dhe Memaliaj) dhe jo më vonë se data 31.10.2024 (me Bashkinë Poliçan), ose çdo dokumentacion tjetër që rregullon pronësinë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti